

Mesazhet kryesore për mjekët e rinj dhe studentët

Merrni parasysh këto mesazhe, si edhe ato për grupet specifike të synuara që lidhen me fushën tuaj të specializimit.

Çka mund të bëni?

1. Mësoni dhe zbatoni të gjitha rekomandimet e përdorimit të antibiotikëve dhe të parandalimit e kontrollit të infeksioneve [konsensusi i ekspertëve].
2. Kur shihni që dikush ka përshkruar një antibiotik, pyesni përshkruesin për indikacionet, përzgjedhjen, dozën, mënyrën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit, për të kuptuar nëse përshkruesi ka zbatuar udhëzimet për përdorimin e antibiotikëve [69].
3. Nëse shihni anëtarë të stafit në spital ose në institucionet tjera shëndetësore që shkelin udhëzimet ose protokollin, pyetini pse po e bëjnë këtë dhe sigurojuni mjete për të kuptuar se çfarë po bëjnë gabim [69] [konsensusi i ekspertëve].
4. Para se të përshkruani një antibiotik, duhet të [25,26,53,70] [konsensusi i ekspertëve]:
 - Kërkoni udhëzime dhe këshilla nga një koleg me më shumë përvojë ose një anëtar i ekipit të administrimit të përgjegjshëm antibiotikëve;
 - Kontrolloni të dhënat epidemiologjike lokale, rajonale dhe kombëtare;
5. Të dokumentoni në fletëregjistrin e pacientit indikacionet për trajtimin me antibiotikë, përzgjedhjen e ilaçit, dozën, mënyrën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit [31,42,70,71].
6. Përgjigjuni pyetjeve kryesore të mëposhtme për të optimizuar terapinë me antibiotikë. Nëse keni dyshime, konsultohuni me ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve [31,42,53,70,71]:
 - a) A ka një probabilitet më të lartë për praninë e një infeksioni bakterial, në vend të kolonizimit ose të një infeksioni viral?
 - b) A janë marrë kulturat e duhura para fillimit të terapisë me antibiotikë?
 - c) A keni verifikuar përdorimin e fundit të antibiotikëve, alergjitë ndaj ilaçeve, përdorimin e terapisë immunosupresive, spitalizimin ose institucionalizimin e fundit, udhëtimet e fundit jashtë Evropës dhe rezultatet mikrobiologjike në 3 muajt e mëparshëm;
 - d) A ka pacienti një infeksion që mund të trajtohet me antibiotikë?

Nëse po:

 - i. A merr pacienti antibiotikun(ët) e duhur, në dozën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme të administrimit?
 - ii. A mund të përdoret një antibiotik me një spektër më të ngushtë për të trajtuar infeksionin?
 - iii. Për sa kohë duhet të marrë pacienti antibiotik(ë)?

7. Sigurohuni që pacientët (dhe familjet e tyre) të kuptojnë arsyet e terapisë me antibiotikë dhe këshillat kryesore që lidhen me përdorimin e antibiotikëve, duke përfshirë [31,69] [konsensusin e ekspertëve]:

- a) Të marrin antibiotikët saktësisht siç përshkruhet nga mjeku;
- b) Të mos i ruajnë kurrë antibiotikët për përdorim të mëvonshëm;
- c) Të mos përdorin kurrë antibiotikë të mbetur nga trajtime të mëparshme; dhe
- d) Të mos shkëmbejnë kurrë antibiotikët e mbetur me njerëz të tjerë.